



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 11 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.05.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIMIN E AKTIVITETEVE TË KRYETARËVE TË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE DHE LAGJEVE URBANE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

- I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 27.000.00 € (njëzet e shtatë mijë euro), për subvencionimin e aktiviteteve të 54 (pesëdhjetë e katër) kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit me nga 500 € (pesëqind euro) për secilin kryetar të këshillit të fshatit apo lagjes urbane.
- II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të subvencionimit përkatësisht ofrimit të mbështetjes financiare për aktivitetet e zhvilluara të kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane.
- III. Mjetet financiare për ekzekutimin e këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2025, mjetet e buxhetit të komunës, kodi i programit 21/613/85003/200/00000/0820 në xhirollogarinë bankare personale të secilit kryetar/e të këshillit të fshatit apo lagjes urbane.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është lista e kryetarëve të këshillave të fshatrave – lagjeve urbane.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.
- VI. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-27009
Lipjan, më 29.05.2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi